



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo životne sredine, prostornog planiranja i
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Në bazë të Ligjit Nr. 08/L – 197 për zyrtarët publikë, Neni 39 (1,2,3,4,5 dhe 6) dhe Rregullores (QRK) NR. 15/2023 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovë, Neni 5 Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Grupi i inxhinierisë së ndërtimit
Titulli i pozitës së punës	Inspektor i Infrastrukturës Rrugore
Klasa e pozitës	Profesional 1
Koeficienti/Paga	7.5
Nr. i kërkuar	1
Kohëzgjatja e emërimit	Emërim me afat të pacaktuar
Data e njoftimit	24/03/2025
Afati për aplikim	25/03/2025 - 23/04/2025
Institucioni	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Departamenti	Divizioni i Inspektimit për Infrastrukturë Rrugore
Divizioni	
Vendi i punës	Prishtinë
Nr. i Referencës	RN00017359
Kodi	RPC0010898



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Kontrollon dokumentacionin teknik lidhur me ndërtimin, rikonstruktimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve publike dhe objekteve në këto rrugë;
- Kontrollon zhvillimin e punimeve në ndërtimin, rikonstruktimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e rrugëve publike;
- Kontrollon materialet me rastin e zhvillimit të punimeve a janë duke u zbatuar standardet, normat dhe kriteret teknike gjatë ndërtimit, rekonstruksionit dhe mirëmbajtjes së rrugëve publike;
- Kontrollon plotësimin e kushteve për personat të cilët merren me projektim, revizionin dhe kontrollin e dokumentacionit teknik, udhëheqjen, ekzekutimin e punimeve dhe mbikëqyrjen profesionale;
- Kontrollon me rastin e ndërtimit, rikonstruktimit të rrugës publike, pjesëve të saja si dhe objekteve rrugore, leja e ndërtimit dhe të konstatohet se a është lëshuar në mënyrë të rregullt;
- Kontrollon transportin e jashtëzakonshëm, si dhe të verifikohet leja për këtë transport;
- Kontrollon se a është punë kryesi i ndërtimit dhe rikonstruktimit të rrugës publike, pjesëve të saja dhe objekteve në rrugë duke e mbajtur librin inspektues dhe ditarin ndërtimor në mënyrë të rregullt;
- Ndërpret punimet të cilat kryhen në kundërshtim me dispozitat ligjore, normat dhe standardet teknike gjatë zhvillimit të punimeve dhe përdorimit të materialit ndërtimor në mirëmbajtjen, ndërtimin dhe rikonstruktimin e rrugëve publike;
- Ndërpret punimet të cilat zhvillohen në afërsi të drejtpërdrejt të rrugës publike;
- Përrjashton prej komunikacionit automjetin i cili qarkullon në rrugë publike pa lejen për transport të jashtëzakonshëm;
- Urdhëron mënjanimin e të metave të konstatuara në rrugën publike të cilat e rrezikojnë zhvillimin e komunikacionit në rrugën publike;
- Urdhëron ndërprerjen e punëve dhe rrënimin e objektit i cili ndërtohet në brezin e rrugës dhe brezin mbrojtës të rrugës publike;
- Urdhëron mbi marrjen e masave për siguri të rrugës publike dhe të ndaloj përkohësisht komunikacionin për automjetet të cilat për shkak të peshës së vet të përgjithshme, dimensioneve dhe cilësive tjera teknike mund të shkaktojnë dëme rrugës publike ose të rrezikojnë sigurinë e qarkullimit të automjeteve në rrugën publike;
- Ndalon komunikacionin në rrugën e ndërtuar ose të ri konstruktuar, objektin e rrugës, ose në një pjesë të rrugës nëse nuk është dhënë leja për përdorimin e rrugës publike apo objektit të rrugës publike;
- Ndalon përdorimin e parkingjeve ose rrugëve lidhëse nëse janë ndërtuar pa lejen ose në kundërshtim me kushtet e dhëna në leje;
- Ndërmerr masat dhe veprimet tjera për të cilat është i autorizuar me dispozita të veçanta;
- Bashkëpunon në teren në aksione të ndryshme të organizuara me inspektoret tjerë çoftë të nivelit Lokal apo Qendror, me Policinë e Kosovës (Njësitë e Trafikut), lidhur me gjendjen e rrugëve publike;
- Kryen edhe detyra tjera në përputhje me ligjet dhe rregulloret të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi.



2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
- Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
- Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës.
- Të kaloj me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- **Arsimimi i kërkuar:** Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për fushën e TIK.
- Fusha: Inxhinieri e Ndërtimit, Inxhinier Strukturore, Inxhinieri Arkitekturore, Inxhinieri Gjeoteknike, Hidroteknikë;
- **Kërkesat specifike:** Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase.
- **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Njohuri të thella dhe të specializuara në fushën profesionale specifike.
- Nivel të lartë të njohurive profesionale ose teknike të fushës përkatëse dhe të kuptuarit e fushave që ndërlidhen me detyrat dhe përgjegjësitë.
- Njohuri të gjëra të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike.
- Aftësi të arsytimit logjik dhe analizës.
- Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave.
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale.
- Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- Njohja e gjuhëve të huaj (e preferueshme).



5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës.
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit(vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal. Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës së lëshuar nga organi kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer dhe noterizuar të përvojës të lëshuar nga punëdhënësi përkatës.
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.
- Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit

- Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se(6) muaj nga data e lëshimit.
- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore.
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar.
- Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (Kandidatët që janë të punësuar apo kanë qenë të punësuar në institucione publike).

6. Data e daljes së rezultateve të vlerësimit paraprak

- Lista e kandidatëve të cilët plotësojnë kushtet për pranim do të shpallet më së largu deri më datën 08/05/2025, në portalin e rekrutimit elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Kriteret specifike shtesë

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim – maksimumi 70 pikë
- Intervista – maksimumi 30 pikë

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)



10. Mënyra e aplikimit

- Përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutimi elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

- Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, njësia përgjegjëse bën verifikimin para emërimit me qëllim të vërtetimit se kandidatët vazhdojnë të plotësojnë kriteret e konkursit, përmes dokumenteve në origjinal apo të njësuara me origjinalin.

Komitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre, personat me aftësi të kufizuar dhe gjinia më pak e përfaqësuar kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në LZP. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen

